

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ALPE Helt, shoqëri për investime d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni dhe personi fizik Jadranka Primorac, XXX, Kroaci, përmes Shoqërisë së Avokatëve Knezoviq dhe bashkëpunëtorët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 23.07.2025, solli këtë

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin ALPE Helt, shoqëri për investime d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni dhe personi fizik Jadranka Primorac, XXX, Kroaci, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ORIGO ZDRAVLJE d.o.o. për këshillim dhe menaxhim, me seli të regjistruar në rrugën Knez Bраниmir 71E, Zagreb, Kroaci, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë pengim, kufizim apo shtrembërim të ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve **dhe është në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria paguese 840...03161, kodi i të hyrave dhe programi 72231300.

3. Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 02.07.2025, dhe i plotësuar më 14.07.2025, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga ALPE Helt, shoqëri për investime d.o.o., me seli të regjistruar në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni dhe personi fizik Jadranka Primorac, XXX, Zagreb, Kroaci, me të cilin ALPE Helt, shoqëri për investime d.o.o. dhe Jadranka Primorac do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi ORIGO ZDRAVLJE d.o.o. për këshillim dhe menaxhim, me seli të regjistruar në rrugën Knez Bраниmir 71E, Zagreb, Kroaci.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimi të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

ALPE Helt, shoqëri për investime d.o.o., është anëtare e ALFI SKLADI, grupi më i madh për menaxhimin e fondeve alternative të investimeve në Slloveni, i cili përfshin gjashtë fonde të ndryshme alternative me mjete nën menaxhim në vlerë prej mbi 500 milionë euro.

Veprimtaria e regjistruar e ALPE Helt, shoqëri për investime d.o.o., janë aktivitete të tjera të këshillimit afarist dhe të menaxhimit.

Grupi ALFI aktualisht ka një shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Shoqëria për tregti dhe shërbime APOLLO MK SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në bul. Kiro Gligorov nr. 13 Shkup me veprimtari prioritare 46.49 – tregti me shumicë e produkteve të tjera për amvisëri.

Jadranka Primorac, Kroaci është ortakë e vetme në Shoqërinë KONZORCIUM d.o.o. për këshillim dhe menaxhim, me seli të regjistruar në Zagreb, Sheshi John Fitzgerald Kennedy 6B.

KONZORCIUM d.o.o. për këshillim dhe menaxhim nuk ka shoqëri të lidhur, filiale apo përfaqësi të themeluara në Maqedoni dhe nuk realizon asnjë të hyrë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Veprimtaria e regjistruar e **ORIGO ZDRAVLJE d.o.o. për këshillim dhe menaxhim** është veprimtaria e aktiviteteve të këshillimit afarist dhe të menaxhimit.

ORIGO ZDRAVLJE d.o.o. për këshillim dhe menaxhim nuk ka filiale, përfaqësi apo degë në Maqedoninë e Veriut, dhe as nuk realizon asnjë të hyrë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ